

- Ankesa: S'ka

[illegible]

|        |                                  |        |      |   |      |  |  |     |      |
|--------|----------------------------------|--------|------|---|------|--|--|-----|------|
| 3      | Ekon.kull.<br>Guri top<br>gjemth | 7a (k) | -    | - | 3.00 |  |  | 362 | 3.00 |
| 4      | Ekon.kull.<br>Guri top<br>gjemth | 7a (k) |      |   | 0.30 |  |  | 362 | 0.30 |
| 5      | Bishnice                         | 23a    | 0.20 |   |      |  |  | 276 | 0.20 |
| Shuma: |                                  |        | 0.55 |   | 3.30 |  |  |     | 3.85 |

a. Qellimi i dhënies me qira të këtij objekti është sigurimi i të ardhurave për Bashkinë Pogradec.

b. Çmimi dysheme për fillimin e konkurimit është 307 500 (Treqind e shtate mijë e pesëqind) lekë në vit, sipas përcaktimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave".

c. Kohëzgjatja e kontratës të qirasë të jetë jo më shumë se 10 vjet, me të drejtë ripërtëritje.

d. Veprimtaria që do të ushtrohet nga qiramarrësi në këtë objekt, duhet të jetë në përputhje me funksionin "Për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike kampingje (kënde lodrash, mjedise sportive, shlodhëse etj.)

II. Vlerësimi i kriterëve të konkurimit për subjektet që do të aplikojnë do të jetë:

- a. Projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit 20 pikë.
- b. Planbiznesi dhe investimet që do të bëhen 15 pikë.
- c. Planin e rehabilitimit të sipërfaqes 25 pikë.
- d. Nivelin e punësimit në veprimtari 5 pikë.
- e. Masën e qirasë për ha/vit 35 pikë.

III. Vlerësimi do të bëhet sipas formulës si më poshtë:

$P_i - V_i \times P_{max} / V_{max}$

$P_i$  - pikët e ofertës që vlerësohet

$V_i$  – vlera e ofertës që vlerësohet

$P_{max}$  - pikët maksimale

$V_{max}$  - vlera e ofertës maksimale.

IV. Personat fizikë dhe juridikë që marrin pjesë në konkurrim duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesën e subjektit për marrjen me qira të pasurisë shtetërore, ku të deklarohej oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë, qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore, si dhe treguesit e konkurrimit të parashikuar sipas planit të biznesit.
2. Ekstraktin e regjistrimit në QKB për objektin e veprimtarisë.
3. Projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar.
4. Planbiznesin dhe investimet që do të bëhen.
5. Të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron.
6. Planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme.
7. Nivelin e punësimit në veprimtari.
8. Lejen mjedisore për aktivitetin e kërkuar.
9. Çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit.
10. Adresën e subjektit, telefon, email dhe faks.

V. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrim, janë:

- a) garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes.
- b) të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV-në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë.
- c) vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, hetim në proces, detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve.

VI. Ky dokumentacion të paraqitet në një zarf, të mbyllur, të nënshkruar nga konkuresi, me mbishkrimin "Ofertë për dhënie me qera të fondit pyjor" në zyra e Arkiv - Protokollit, Kati II, Godina e Bashkisë Pogradec dhe më pas i dorëzohet Komisionit nga zyra e Arkiv - Protokollit, Bashkia Pogradec, në orën e hapjes së konkurrimit.

VII. Ofertat/ dokumentacioni/zarfi dorëzohen nga të interesuarit/konkurrentët fizikisht, me postë ose dorazi.

VIII. Mosparaqitja e njërit prej dokumentave të mësipërme, përbën kusht skualifikues.

IX. Vendi i zhvillimit të konkurrimit: Salla e Keshillit Bashkiak, Kati I, Bashkia Pogradec.

X. Afati i paraqitjes së ofertave të konkurrentëve do të jetë jo më parë se 10 ditë kalendarike nga data e botimit të këtij njoftimi në buletin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

Afati kohor përfundimtar, për dorëzimin e ofertave konkurruese është data 13/11/2020, nga ora 12<sup>00</sup>, ku do të bëhet edhe dorëzimi i tyre pranë Komisionit Dhënies me Qera.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rremë e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.